VENDIM
Nr. 123, datë 5.3.2014

PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT E TË SHPËRBLIMIT TË KOMISIONIT TË MBROJTJES NGA RREZATIMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 6 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet (në vijim KMRR), i cili kryesohet nga ministri i Shëndetësisë dhe ka në përbërje:

a) një përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik;

b) një përfaqësues jurist nga Ministria e Shëndetësisë;

c) një përfaqësues nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar;

ç) një përfaqësues nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me njohuri të thelluara për rrezatimet elektromagnetike, stacionet bazë, frekuencat e transmetimit;

d) një ekspert në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese e jojonizuese;

dh) një anëtar me njohuri të thelluara në fushën e fizikës, elektromagnetizmit dhe bashkëveprimit të rrezatimit jonizues me lëndën, i propozuar nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

2. KMRR-ja, në varësi të problematikës që do të shqyrtohet në mbledhje, thërret ekspertë me njohuri të thelluara në fushën e legjislacionit për mbrojtjen nga rrezatimet, aplikimet e rrezatimeve jonizuese për sigurinë fizike të burimeve radioaktive, rrezatimeve jojonizuese. Këta ekspertë propozohen nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe miratohen nga kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.

3. KMRR-ja është autoriteti kombëtar rregullator, i cili mbikëqyr dhe siguron zbatimin e ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, të ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese" dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese.

4. Kryetari i Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet është sekretar i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.

5. KMRR-ja mblidhet, si rregull, një herë në 2 (dy) muaj, sipas njoftimit të kryetarit dhe mbledhjet zhvillohen me jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Njoftimi, ku përcaktohen rendi i ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje, u dërgohet anëtarëve të komisionit të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

6. Kur një anëtar nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, përjashtohet me vendim të kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe zëvendësohet nga institucioni përkatës.

7. Mbledhjet e KMRR-së i drejton kryetari dhe, në mungesë të tij, vetë kryetari cakton një anëtar të komisionit për drejtimin e mbledhjes.

8. Procesverbali për çdo mbledhje mbahet nga personi i caktuar nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, i cili merr pjesë rregullisht në çdo mbledhje.

9. Mandati i anëtarëve të komisionit është katërvjeçar. Nëse institucioni përkatës nuk paraqet ndryshim, pas skadimit të afatit të mandatit, atëherë mandati i personit është i vlefshëm dhe për katër vite të tjera.

10. KMRR-ja miraton çdo vit raportin vjetor për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues në Republikën e Shqipërisë, të përgatitur nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet në bashkëpunim me institucione të tjera të fushës.

11. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar dhe për sekretarin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore".

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

13. Vendimi nr. 510, datë 13.5.2009 i Këshillit të Ministrave "Për ngritjen, përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet", shfuqizohet.

14. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama